



Data: 01.10.19 Ref.: 18251/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 78-të të mbajtur më 29.09.2019 mori këtë:

V E N D I M

- I. Anullohet pjesërisht vendimi nr. 305/19D, datë 25.02.2019 për tërheqje të akreditimit, dhe rikthehet akreditimit për programet e studimit të Kolegjit "UBT":
 - Infermieri BSc 180 ECTS, maksimum 50 student për vit akademik
 - Sisteme të Informacionit BSc 180 ECTS
- II. Refuzohet kërkesa për rikthimin e programit:
 - Media dhe Komunikim MA 120 ECTS
- III. Tërhiqet akreditimi për programin e studimit:
 - Sisteme të Informacionit MSc 120 ECTS
- IV. Kohëzgjatja e akreditimit për programet e studimit të sipër përmendura është e njëjtë me vendimin për zgjatje të akreditimit, nr. 460/18D, datë 18.05.2018
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.


A r s y e t i m i

Kolegji UBT ka parashtruar kërkesë për rialokim të stafit nr. 1682/19H, datë 20.09.2019 me qëllim të përmbushjes së kriterëve për programet e studimit, në përputhje me Udhëzimin Administrativ 15/2019.


Këshilli Shtetëror i Cilësisë ka analizuar propozimet për rialokim të stafit, dhe fushën e ekspertizës për secilin staf akademik. Mbi këtë bazë, KShC pas analizës së bërë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sa i përket programit të studimit Sistemet e Informacionit MSc 120 ECTS, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në bazë të kërkesës nr. 1879/19H, datë 30.09.2019 vendosi për tërheqje të akreditimit të këtij programi studimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji UBT
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.